

V E N D I M
Nr.101, datë 15.3.1994

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.15 DATË
24.1.1994 “PËR PAGESEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERSONAT ME PAAFTËSI”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe të Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.15, datë 24.1.1994, pika 1 ndryshohet si vijon:
“Ndihma ekonomike për personat me paaftësi, e paguar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nga muaji korrik i vitit 1993, të vazhdojë të paguhet nga ky institut gjer me 30 qershor 1994”.
2. Pika 2 ndryshohet si vijon :
“Masa e ndihmës ekonomike mujore për personat me paaftësi që banojnë në qytet, është:
a) kur janë kryefamiljarë lekë 1150
b) persona të tjerë lekë 1070
Masa e ndihmës ekonomike mujore për personat me paaftësi që banojnë në fshat, është 470 lekë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi